



02-180-2687 1 05.04.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/03

Datë: 30.03.2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 12.1, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 22, paragrafi 22.1 pika 4) Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.03.2018, mori këtë:

V E N D I M


(për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018)

- I. Me këtë vendim miratohet kërkesa nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2017 në vitin 2018 në vlerë prej 38,528.78 € si ne vijim:
 - Shuma prej 38,528.78 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në kodin 46030 për projektin **Bashkëfinancimi i projekteve**, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.
- II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa për zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga pika I e këtij Vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Ministria e Financave,
- Drejtoria Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





02-180-2688 | 2 | 05-04-2018



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/04

Datë: 30.03.2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 12.2, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 21, paragrafi 21.1 pika j) Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale / në tekstin e mëtejme (projekt) Rregullorja/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.
- III. Bartëse e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartoj në afat prej 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Autorizohet Kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta emëroj grupin punues për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi.
- VI. (projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit (projekt) Rregullorja i procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anë të të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

- X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i komunës së Junikut
- Ministria e Financave,
- Shërbimi i Kuvendit,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





02-180-2685 2 05-04-2018



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/05

Datë:30.03.2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 53, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 36 dhe 38, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Komunitete

- I. Me këtë vendim Kuvendi themelon Komitetin për Komunitete si komitet i përhershëm në Komunën e Junikut dhe përcakton strukturën e tij.
- II. Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme në Komunë neni 10, paragrafi 2, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjidhet me shumicën e votave të anëtareve të Komitetit.
- III. Komiteti për Komunitete do të ketë përbërjen si në vijim:
 1. Xhemë Tofaj - anëtarë, subjekti politik AAK - PDK,
 2. Kreshnik Maloku - anëtarë, subjekti politik AAK - PDK,
 3. Zeqë Hebibi - anëtarë, subjekti politik LDK,
 4. Zenel Maloku - anëtarë, kandidat i pavarur,
 5. Drita Salihu - Hoxha - anëtarë, subjekti politik LVV,
- IV. Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





02-180-2686 2 05.04.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/06

Datë: 30.03. 2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12 paragrafi 12.2 pika d), Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 22 paragrafi 22.1 pika 4, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

për themelimin e komisionit për emërtimin e zonave të qarkullimit publik

- I. Me këtë vendim themelohet komisioni për emërtimin e zonave të qarkullimit publik në komunën e Junikut.
- II. Me shprehjen “ zonë e qarkullimit publik” nënkuptohet pjesa e territorit publik si: bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet, parqet dhe unazat rrugore.
- III. Për mbarëvajtjen e punës së komisionit, i njëjti harton: planin e punës, rregulloren e punës dhe raportin e punës.
- IV. Të gjitha projekt dokumentet nga pika III e këtij vendimi i procedohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.
- V. Projekt plani i punës së komisionit duhet ti procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim më se largu 30 ditë pas themelimit të komisionit.
- VI. Komisioni përbehet nga 7 anëtarë. Nga 1 anëtar nga secili subjekt politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës dhe anëtari i pavarur, ndërsa 2 nga ekzekutivi i Komunës.
- VII. Propozimet nga pika VI e këtij vendimi duhet t’i behën kryesuesit të Kuvendit të komunës me se largu 30 dit nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi.
- VIII. Komisioni është organ këshillëdhënës, kurse për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të komunës.
- IX. Mbledhjet e komisionit i udhëheq kryetari i komisionit i cili do të zgjidhet në mbledhjen inauguruese të komisionit.

- X. Kryetari i Komisionit zgjidhet sipas nenit 8 paragrafi 8.7 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

